



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 70 dt. 13.04.2016

Në mbështetje të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 13.04.2016, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratohet projekti “Rikonstruksioni i objektit “Godina e Inovacionit”(Ish Inima) – faza II, me subjekt aplikues ASIG, Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike.
2. Të merren masa për heqjen e kondicionerëve nga fasadat e objektit “Godina e Inovacionit”, (Ish Inima), monument kulture kategoria e II-të.
3. Pas heqjes së kondicionerëve nga fasadat, të realizohet pastrimi dhe restaurimi i të gjitha fasadave të objektit “Godina e Inovacionit”, (Ish Inima), monument kulture kategoria e II-të.
4. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI

KRYETAR
MIRELA KUMBARO JURXHI

